



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Data e marrjes së titullit: 20.09.2023			
Vendndarja e titullit:		087 1752	

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Thirrje për mobilitet të studentëve në Universitetin e PH Zug në Zvicër

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes UKZ dhe PH Zug për mobilitetin e studentëve, do të bëhet përzgjedhja e studentëve për vizitën studimore në Universitetin PH ZUG në Zvicër, e cila u mundëson 15-të studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" të jenë pjesë e këtij shkëmbimi.

Mobilitetet ndihmojnë studentët e UKZ-së të ngriten profesionalisht dhe të përfitojnë nga eksperiencat e ndryshme që ata marrin nga vizitat e shumë vendeve dhe Universiteteve Ndërkombëtare, prandaj aplikoni për të pasur një eksperiencë në Universitetin e PH Zug në Zvicër.

Mobiliteti i studentëve të UKZ-së në Zvicër do të realizohet në muajin dhjetor 2023, paraprkishtë studentët e përzgjedhur të UKZ-së do të presin studentët nga PH Zug në muajin tetor 2023, ku përgjatë një(1) jave do të ketë aktivitete të ndryshme.

Përzgjedhja e studentëve tanë do të bëhet duke ju përmbajtur kritereve të mëposhtme:

1. Gjithsej 15 studentë do të jenë pjesë e programit për vitin 2023;
2. Mobiliteti zgjat një(1) javë;
3. Gjithsej do të pranohen 15 studentë, të gjithë nga Fakulteti i EDUKIMIT;
4. Nëse nuk do të mbushet numri vetëm nga studentët e Fakultetit të EDUKIMIT atëherë proporcionalisht do të pranohen edhe studentë nga Fakultetet e tjera;
5. Studentët duhet të flasin gjuhën angleze, përparësi llogaritet edhe gjuha gjermane (do të testohen për gjuhë në ZMJ);
6. Studentët duhet të kenë aftësi komunikimi, pune në grup, të jenë të përkushtuar për programin dhe të i përmbahen programit, të punojnë paraprkishtë me studentët e PH Zug dhe të i përshtaten kërkesave të ZMJ për realizimin e programit;
7. Të jetë i/e gatshme të mirëpres në shtëpi një student nga PH Zug për një javë;
8. Të marrë pjesë në të gjitha grupet punuese në UKZ, gjatë vizitës së studentëve nga PH Zug;

Të gjithë studentët e interesuar, duhet të lajmërohen tek Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së, deri me datën 29/09/2023, nga ora 09:00-16:00 CET dhe duhet të kenë me vete:

- o Vërtetimin që janë studentë;
- o Certifikatën e notave dhe
- o Kopjen e pasaportës me vlefshmëri minimale të afatit deri me 31/12/2024.

Suksese të gjithë studentëve.



Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte